



Npi – 01/127 datë: 03.04.2025

Bazuar në Nenet 12.2 shkronja (d), si dhe Nenin 58 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Statutin e Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Nenin 5 dhe nenin 10, paragrafin 2, të Rregullores Komunale për Simbolet, Titujt e Nderit, Dekoratat, Medaljet, Mirënjohjet dhe Falënderimet me numër, Npi – 01/173, të datës 27.05.2009; Si dhe duke u bazuar në vendimin e Kuvendit të Komunës së Shtimes për formimin e Komisionit për ndarjen e çmimit “Nderi i Qytetit” me numër Npi-01/76 të datës 26.02.2024, Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e mbajtur më 03.04.2025, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E ÇMIMIT “NDERI I QYTETIT” TË KOMUNËS SË SHTIMES

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e -III- për vitin 2025 të mbajtur më 03.04.2025, me shumicën e votave miratoi vendimin për ndarjen e Çmimit “Nderi i Qytetit”, të Komunës së Shtimes, për profesorët e suksesshëm të Komunës së Shtimes, si vijon:

1. Prof. Fadil Hysaj – Shtime,
2. Prof. Ismajl Hasani – Shtime, (Post mortum)

II

A r s y e t i m: Kuvendi i Komunës së Shtimes, duke u bazuar në kompetencat e veta në bazë të kornizës ligjore të përshkruar më lartë, dhe pas diskutimeve lidhur me historikun e 2 Profesorëve univerzitar të suksesshëm të Komunës së Shtimes, ka vendosur të ndajë çmimin “Nderi i Qytetit” të Komunës së Shtimes, sipas dispozitivit të këtijë Vendimi. Kuvendi, ka marrë parasysh edhe Rekomandimin Npi-01/118 dt.01.04.2025, të Komitetit për Politikë dhe Financa, si dhe Rekomandimin Npi – 01/109 datë: 26.03.2025, të Komisionit për ndarjen e çmimit “Nderi i Qytetit” të Komunës së Shtimes.

Profesorët Fadil Hysaj, dhe Ismajl Hasani (i ndjerë) kanë qenë dhe janë, personalitete të spikatura dhe të merituar edhe në rrafshin kombëtar por edhe ndërkombëtar. Kanë kontribuar shumë në veçanti në fushën e Arsimit, Shkencës, Kulturës dhe Artit të Komunës së Shtimes, por edhe në përgjithësi në rrafshin kombëtar për edukimin e brezit të ri. Po ashtu suksese kanë edhe në rrafshin ndërkombëtar me punime shkencore e studimore në fushën e shkencave sociologjike, si dhe në fushën e dramaturgjisë dhe kinematografisë.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palëve, Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryetari i Kuvendit
Adnan Ademi